

MENDIM PAKICE

1. Unë, anëtarja e trupit gjykues Etleda Çiftja, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Pjetërnikaj.

2. Në mbështetje të qëndrimit kundër, po argumentoj në vijim arsyet mbi të cilat kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, të cilat në përfundim më kanë çuar në vlerësimin se subjekti duhet të ishte shkarkuar nga detyra, për sa më poshtë vijon:

3. **Për rivlerësimin e pasurisë.** Si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë e gjejmë të materializuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku realizimin e qëllimit të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, këto norma e konkretizojnë në identifikimin e subjekteve që: (i) kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht; ose (ii) nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin kushtetues për të shpjeguar bindshëm *burimin e ligjshëm të pasurive, ekzistencën e të ardhurave të ligjshme* dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

4. Unë, si anëtare në pakicë, ndryshe nga arsyetimi dhe përfundimet e shumicës së trupit gjykues për këtë kriter, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, për sa më poshtë vijon:

5. **Lidhur me pasurinë e deklaruar në deklaratën Vetting, banesë 2 kate + papafingo me sip. 460 m² dhe 2 njësi shërbimi (stalla) me sip. 140 m² dhe 40 m², ndodhur në fshatin ***, Tropojë**

5.1 *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin lidhur me vitin/kohën e ndërtimit të secilit objekt.* Subjekti ka qenë kontradiktor lidhur me vitin/kohën e ndërtimit të banesës 2 kate + papafingo dhe 2 objekteve të tjera me destinacion stallë, pasi: (i) në deklaratën Vetting ka deklaruar që ajo është ndërtuar në vitin 1990 nga prindërit e familjarët e tjerë, si dhe është rikonstruktuar në vitin 2007 dhe së brendshmi në vitin 2014; (ii) në deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2013, ka deklaruar që është ndërtuar në vitin 1991 (rikonstruktuar në 2007-ën); (iii) në shpjegimet e dhëna para ILDKPKI-së, më 31.3.2016, ka deklaruar që është ndërtuar në vite, duke filluar nga viti 1992; (iv) në formularët e vetëdeklarimit për legalizim, datë 19.12.2014, që janë pjesë e dosjes së përcjellë nga ILDKPKI-ja, është deklaruar që objektet janë ndërtuar në vitin 2005.

5.2 *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin lidhur me pjesën takuese.* Subjekti ka deklarime kontradiktore lidhur me pjesën takuese në këto pasuri në raport me dokumentacionin e administruar, pasi: (i) në DIPP-në para fillimit të detyrës së vitit 2013, ka deklaruar pjesën në përqindje 100% të pasurisë banesë; (ii) në deklaratën Vetting ka deklaruar pjesën në përqindje 25%, me shpjegimin: “Në momentin e legalizimit do të bëhet pjesëtimi vullnetar, shkak për të cilin unë kam deklaruar vetëm 25% të saj”; (iii) në vetëdeklarimin

pranë ALUIZNI-t subjekti është deklarues i vetëm; (iv) banesa 2 kate + papafingo dhe 2 njësitë e shërbimit stallë janë regjistruar përfundimisht 100% në emër të subjektit.

5.3 *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin lidhur me sipërfaqen dhe numrin e objekteve të deklaruara.* Subjekti i rivlerësimit ka deklarime kontradiktore lidhur me sipërfaqen dhe numrin e objekteve, si vijon: (i) në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar objekte me destinacion stallë për bagëti, me sip. 140 m² dhe sip. 40 m², (ii) në DIPP-në para fillimit të detyrës së vitit 2013 nuk ka deklaruar objekte me destinacion stallë për bagëti; ndërsa (iii) në shpjegimet e dhëna para ILDKPKI-së në datën 31.3.2016 ka deklaruar se ka aplikuar për legalizim për tri objekte: (1) për banesën me sip. 460 m²; (2) dy stallat e bagëtive rreth 140 m²; dhe (3) një sipërfaqe e vogël banese prej 40 m², e cila është e shkëputur nga banesa kryesore; (iv) në formularët e vetëdeklarimit për legalizim nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen e objekteve, por nga planimetritë bashkëlidhur vetëdeklarimit¹ rezulton se janë dy objekte me sipërfaqe, përkatësisht 100 m² dhe 45.90 m². Planimetritë e tjera të depozituara po për efekt të vetëdeklarimit (ka depozituar planimetri të ndryshme për të njëjtin objekt) kanë sip. 120 m² dhe 36 m²; (v) objektet e legalizuara dhe regjistruara në ASHK janë me sip. 101.25 m² dhe sip. 48.40 m².

5.4 Për sa kohë vetë subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore lidhur me sipërfaqen dhe numrin e objekteve, pjesën e tij takuese, kohën dhe vlerën e ndërtesës, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, është e pamundur të dallohet se cili deklarim është i vërtetë dhe cili ka qenë shkaku që e ka detyruar subjektin e rivlerësimit për të mos respektuar kërkesat urdhëruese të ligjit për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht sipërfaqen, numrin e objekteve, pjesën e tij takuese, kohën dhe vlerën e krijimit për këto pasuri.

5.5 Më tej, në kushtet që: (i) subjekti ka deklarime kontradiktore dhe nga dokumentacioni i administruar nuk mund të arrihet në një përfundim për kohën e ndërtimit dhe numrin e objekteve të ndërtuara; (ii) nga vëzhgimi i objektit në platformën *google earth* vërehet se nga krahasimi i ortofotos së vitit 2013² me ortofoton e viteve 2015 dhe 2016 ka ndryshime të dukshme sa i përket konfiguracionit dhe sipërfaqes së objektit të banimit, ku kjo e fundit është zmadhuar; (iii) nga kuotat e objektit për të cilat ka informuar ASIG-u, vihet re ndryshimi i lartësisë në njërin pjesë të objektit; (iv) investimi i kryer në këtë banesë në vitin 2014 është në shumën 8.565.175 lekë, sipas referencës së EKB-së, por edhe provave të depozituara nga subjekti (akt ekspertimi privat); (v) nga provat e administruara gjatë hetimit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë vetëdeklarues i vetëm i këtij ndërtimi pranë ALUIZNI-t dhe më tej regjistrimi i pronës në ASHK është bërë vetëm në emër të subjektit të rivlerësimit si investues i vetëm, **subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur duhet të justifikojnë burimin e ligjshëm të krijimit të investimit/ndërtimit të kryer në vitin 2014, në shumën 8.565.175 lekë, vit në të cilin ka qenë në detyrën e prokurorit, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.**

¹ Aneks nr. 4/1 i dosjes së ILDKPKI-së.

² Vendosur në dispozicion nga subjekti.

5.6 Bazuar në arsyetimin më lart, subjekti dhe personat e lidhur duhet të provojnë ligjshmërinë dhe mjaftueshmërinë e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer si burim krijimi për investimin prej 8.565.175 lekësh në vitin 2014.

5.7 Në deklaratën Vetting subjekti nuk ka deklaruar burimin e pasurisë, por ka dhënë sqarime në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për rikonstrukcionin e bërë në vitin 2014, duke deklaruar të njëjtin burim si në procesverbalin pranë ILDKPKI-së në vitin 2016: të ardhura të deklaruara në DPFD-në e vitit 2013 (likuiditeti *cash* prej 20.000.000 lekësh) të akumuluar ndërvite nga anëtarët e familjes, si dhe nga të ardhurat e fermës.

5.8 Lidhur me të ardhurat nga ferma. Referuar pikës 4 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”.

5.9 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti gjatë hetimit apo prapësimeve të tij në përgjigje të barrës së provës dokumentacion ligjor justifikues mbi të ardhurat faktike të siguruara nga ferma. Një gjë e tillë pranohet edhe nga shumica e trupit gjykues në konkluzionin e tij në pikën 26.11 të vendimit, ku shprehet se: “[...] Në këto kushte, mungojnë të dhënat për masën e të ardhurave nga aktiviteti blegtoral e bujqësor. Ndërkohë, Komisioni ka administruar shkresën e Agjencisë Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër, e cila ka përcjellë një tabelë mbi fitimin neto për vitet 2007 – 2020 të familjes bujqësore. Nga një përlllogaritje rezultoi se të ardhurat 2008 – 2013 sipas kësaj shkrese, janë në vlerën 23.558.371 lekë. Nisur nga fakti se ky informacion është bazuar në të dhëna statistikore, në përfundim të hetimit administrativ mbetet e pavërtetuar masa faktike e të ardhurave nga ferma dhe, për këtë arsye, në përfundim të hetimit administrativ nuk janë përlllogaritur të ardhurat nga ferma të deklaruara si likuiditet *cash* në vlerën 20.000.000 lekë në DPFD-në e vitit 2013 [...]”. Pra, të ardhurat nga ferma mbeten në nivel deklarativ dhe të paprovuara me dokumentacion ligjor, sipas nenit D të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

5.10 Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk provuan të kundërtën e barrës së provës dhe, për rrjedhojë, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhura në shumën 8.565.175 lekë nga blegtoria dhe bujqësia, që kanë shërbyer për investimin/ndërtimin në vitin 2014, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

6. Lidhur me apartamentin me sip. 112.98 m², në *, Tiranë, në përdorim të subjektit, blerë nga personi i lidhur/vëllai i subjektit në vitin 2014**

6.1 Në deklaratën Vetting 2017, subjekti deklaroi: “Apartament me kod ***, me sip. 112.98 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, adresa ***, rruga “***”, në përdorim tim aktualisht, por në pronësi të vëllait tim Y. P., blerë me diferencën e të ardhurave të akumuluar ndërvite nga familja ime pas rikonstrukcionit dhe blerjes së mjetit të deklaruar më sipër, deklaruar në ILDKPKI në vitin 2013”.

6.2 Në deklaratën *Vetting* vëllai i subjektit Ylli Pjetërnikaj ka deklaruar: “*Mobilimi i apartamentit është bërë me të ardhurat e familjes, të grumbulluara ndër vite nga punësimi i anëtarëve të familjes, si dhe të ardhurat nga ferma. Këto të ardhura na janë dhënë mua dhe vëllait tim Ylli Pjetërnikaj nga familja në vitin 2013. Vlera: 2.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%*”.

6.3 Në DIPP-në e vitit 2016 nuk është deklaruar përdorimi i kësaj pasurie, por është deklaruar kjo pasuri tek pasuritë e personit të lidhur, në zotërim 100% të tij, në vlerën 44.000 euro. Si burim i të ardhurave për blerjen e tij janë deklaruar: “(i) *Të ardhurat e familjes të grumbulluara ndër vite nga punësimi i anëtarëve të familjes, si dhe të ardhurat nga ferma. Këto të ardhura na janë dhënë mua dhe vëllait tim Ylli Pjetërnikaj nga familja në vitin 2013...*; (ii) *Kredi e marrë me anë të kontratës nr. *** rep., *** kol., datë 24.12.2014. Kredia e marrë është shlyer në datën 7.6.2016. Të ardhurat për shlyerjen e kësaj kredie kanë ardhur nga kursimet e dhëna nga familja*”.

6.4 Në datën 24.12.2014 është lidhur kontratë kredie bankare dhe hipoteke midis “Raiffeisen Bank” (kredidhënës) dhe Y. P. (kredimarrës) e Ylli Pjetërnikaj (bashkëkredimarrës)³. Sipas kësaj kontrate, shuma për të cilën është lidhur kontrata e kredisë është 4.500.000 lekë dhe qëllimi i dhënies së kredisë është përdorimi i kësaj shume për blerje shtëpie.

6.5 Sipas të dhënave të “Raiffeisen Bank”⁴, kredia është mbyllur në datën 6.6.2016 nga derdhja *cash* e vlerës 4.500.000 lekë e shtetasit Y. P., me përshkrimin “*derdh për mbyllje kredie të ardhurat e familjes*”. Mbyllja e kredisë është deklaruar nga personi i lidhur në DPV-në e vitit 2016 nga kursimet e dhëna nga familja.

6.6 Sipas nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016: “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*”.

6.7 Sipas përcaktimit të pikës 13, neni 3 i ligjit nr. 84/2016: “*‘Person i lidhur’ është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit*”.

6.8 Nga hetimi rezultoi se vëllai i subjektit është pjesë e certifikatës familjare të lëshuar nga gjendja civile, për këtë arsye ka detyrimin e paraqitjes së të gjitha dokumenteve që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 4.500.000 lekë për mbylljen e kredisë më 6.6.2016 dhe shpenzime për mobilim në shumën 2.000.000, me burim nga ferma e familjes.

6.9 Në kushtet që subjekti dhe personi i lidhur nuk paraqitën dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat nga ferma para vitit 2013, por edhe pas vitit 2013, si dhe duke pasur parasysh konkluzionin në pikën 5 më lart lidhur me të ardhurat e deklaruara nga ferma, unë si anëtare në

³ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.12.2014, pjesë e dokumentacionit të përcjellë nga ILDKPKI-ja.

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 17.12.2020, e “Raiffeisen Bank”.

pakicë, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shumën 4.500.000 lekë, paguar në vitin 2016 për mbylljen e kredisë dhe shpenzime për mobilim në shumën 2.000.000 për këtë pasuri, me të ardhura nga blegtorja dhe bujqësia, deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

7. Lidhur me zbatimin e parimit të proporcionalitetit në vendim nga shumica e trupit gjykues

7.1 Referuar qëndrimit tim ndryshe shprehur më lart lidhur me shumën e investimit/ndërtimit prej 8.565.175 lekësh për investimin në banesën 2-katëshe në Tropojë dhe 2 njësitë e shërbimit stallë, por edhe shumat 4.500 000 lekë dhe 2.000.000 lekë, investuar nga personi i lidhur për apartamentin në Tiranë, me burim nga të ardhurat e fermës, unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se konkluzioni në vendimin e shumicës, respektivisht në pikat 45.1, 45.2, 45.3, 45.4 dhe 45.5, lidhur me zbatimin e parimit të proporcionalitetit, nuk qëndron, për aq kohë sa rezultuan problematika të mjaftueshme nga procesi i rivlerësimit lidhur me deklarin jo të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe mungesën e burimeve financiare të ligjshme, të cilat e kualifikojnë subjektin në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në pikën 3 të nenit 61 të po këtij ligji.

Në përfundim të arsyetimit të këtij mendimi pakice, arrij në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Pjetërnikaj, ka deklaruar jo saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për justifikimin e pasurisë, për këtë arsye arrij në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, si dhe se shumica e trupit gjykues nuk duhet të kishte disponuar konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, por shkarkimin e tij nga detyra, sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Etleda ÇIFTJA
Anëtare (kundër)